



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 JANAR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. JANUARA 2015. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrt zakon o izmeni i dopuni Zakona br.04/L-035 o reorganizaciji pojedinih preduzeća i njihove aktive

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI : Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë, andaj fillojmë me punimet e seancës plenare.

Ju njoftoj se në pajtim me vendimin e Kuvendit të 19 janarit 2015, procedojmë me rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Vazhdojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 4/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme, në pajtim me vendimin e Kuvendit të 19 janarit 2015, kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Muhamet Mustafa, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka bërë leximin e dytë të Projektligjit nr. 05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Pas shqyrtimit të kujdesshëm dhe konsultimeve përkatëse me ekspertë ligjorë, ne kemi bërë amendamentin 1 dhe 2. Amendamenti 1 ka të bëjë me tekstin e projektligjit që e kemi. Është vetëm një përmirësim teknik, pra pas fjalës “ligji” të shtohet fjala “bazik”, në mënyrë që të kuptohet.

Kurse, neni 3 riformulohet si vijon: pra neni 41, paragrafi 1, i Ligjit bazik fshihet dhe riformulohet si vijon: “Gjykata lëshon vendim për fillimin e procedurave të likuidimit në bazë të ligjit të ndryshuar për Agjencinë Kosovare të Privatizimit pas kalimit të periudhës prej 18 muajsh nga afati maksimal i lejuar në nenin 22 të Ligjit bazik dhe në pajtim me

nenin 2 të këtij ligji”, dhe në rast se edhe pas këtij afati është teksti siç ka qenë në ligjin bazik vijon.

Ky amendament ka qenë i nevojshëm që ne të sigurohemi edhe më tepër, sepse Dhoma Speciale e Gjykatës Supreme mund, por nuk është e detyrueshme ta shtyjë, domethënë t’i zbatojë afatet që i kemi dhënë ne. Me këtë nen ne e bëjmë të detyrueshme atë shtyrje. Dhe, në këtë mënyrë e kemi bërë një sigurim të plotë për mbrojtjen e aseteve të “Trepçës” që të mos i hyjnë procesit të likuidimit dhe falimentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të drejtën për diskutim e kanë komisionet e përhershme, të cilat e kanë trajtuar projektligjin, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët. Faleminderit!

Në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre janë propozuar gjithsej 2 amendamente nga Komisioni Funkcional, të cilat Profesori i qartësoi paraprakisht dhe materialet ju i keni.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhitjes së paraqitur në raport nga Komisioni Funkcional.

Jemi duke u përgatitur për votim për amendamentin 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 69 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Përgatitemi për amendamentin 2.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 65 vota për, 2 abstenime dhe asnjë votë kundër, miratohet amendamenti 2.

Tani kalojmë në pjesën e votimit të tekstit të projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Prapë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 67 vota për, zero vota kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Me këtë e deklaroj përfundimin e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*